

## Procesverbal

**Konsultim publik** : *Njësia Administrative Bucimas*

**Data** : 18/10/2022

**Ora** : 10:00

**Vendi**: Fshati Bucimas

**Numri i pjesëmarrësve** : Gjithësej 41 persona të pranishëm 8 gra dhe 33 burra).

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** : Paketa Fiskale dhe Buxheti 2023

**Pjesëmarrës** : **Ilir Xhakolli (Kryetar I Bashkise)**

**Irsa Karapanca( Drejtore Financës)**

**Enjela Karafili ( Drejtore, Drejtoria e Tatim Taksave)**

**Ahmed Guxholli (Këshilltar, Bashkia pogradec)**

**Edlir Dervishi (Këshilltar, Bashkia pogradec)**

**Jona Bojko ( Sekretare Këshilli)**

**Matilda Tollaku ( Sekretaria e Këshillit)**

- Takimi drejtohet nga Kryetari i i cili bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :
- Sistemin e Ndrimit që po adaptohet në të gjitha fshatrat e Bashkisë Pogradec
- Sistemin e Furnizimit me ujë të pijshëm të gjitha fshatrave
- Sistemin e Kanalizimeve

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën shprehën problematikat që ata kanë në fshatin ku jetojnë.**

**Alfons Olldashi:**Përsa I përket sistemit të ndimit Bucimasi është pothuajse duke u përfunduar, fshati Gurras kan ngelur vetëm disa lagje dhe në fshatin Rrëmenj duhet të kenë filluar këto ditë.

**Ilir Xhakolli:** Kemi menduar që kurora e Gështenjave momentalisht është në zonën e mbrojtur. Kemi menduar të aplikojmë që ta kemi ne në pronësi dhe ta japim me qera për banorët që duan ti punojnë

**Celnik Capo:** (fshati Gështenjas) Nuk ka korsi për bicikleta dhe për këmbësorët tek rruga Pogradec-Zdërvaskë, gjithashtu rruga kryesore e fshatit Gështenjas është dëmtuar shumë nga firma që bëri kanalizimet. Janë dhe 5 familje po në fshatin Gështenjas të cilat kërkojnë që ujrat e zeza tju kalojnë poshtë rrugës.

**Ilir ( kryeplaku u fshatit Tushemisht):** në fshatin Tushemisht janë bërë shumë investime thjesht një kërkesë si kryeplak është që banoret të informohen më shumë në lidhje me projektet që Tushemishti ka përfituar.

**Gentian Kuqo;** Në fshatin Rrëmenj kemi problem me ndricimin dhe rrugët sa vijnë dhe ngushtohen me asfalt

**Orhan:**Varezat e fshatit Zagorcan të rrethohen.

Mbajtësi i procesverbalit

**Jona Bojko**